



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova



Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Procesverbali i Dëgjimit publik për sektorin e Urbanizmit dhe Shërbimeve Publike

Këtë dëgjim publik në lidhje me buxhetin 2022\2023 e hapi Fatlum Osmani, Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa duke iu urar mirëseardhje të pranishmëve.

Duke thekësuar kështu se diskutimi publik për buxhetin 2022\23 po vazhdon.

Ky dëgjim është realizuar me qëllim të marrjes së kërkesave të banorëve të Komunës së Podujevës.

Poashtu drejtori Osmani thekësoi se Komuna e Podujevës gjatë muajit qershor e ka hartuar dhe e ka miratuar kornizën afatmesme buxhetore. Dhe tani ka filluar procesi i miratimit dhe hartimit të buxhetit i cili do të ndodh në shtator të vitit 2022.

Të gjitha drejtoritë dhe i gjithë ekzekutivi Komunës së Podujevës tregoi Drejtori Osmani se është në kontakt të vazhdueshëm me qytetarët, në mënyrë që të gjitha investimet buxhetore të kryhen në orientim me qytetarët. Sepse në këtë mënyrë arrihet më afër nevojve dhe propozimeve të qytetarëve, dhe buxheti bëhet më gjithëpërfshirës.

Sipas parashikimeve të Qarkores Buxhetore për vitin 2023 ka një rritje të buxhetit, që do të jetë 27. 406.566, që në krahasim me vitin e kaluar buxheti do të jetë përafërsisht 4 milion euro më i madh.

Ky buxhet i vitit 2023 përfshinë të gjitha kategoritë, si atë të pagave, të mallrave, të shërbimeve, dhe të investimeve kapitale dhe atë të subvencioneve. Dhe në të gjitha këto kategori ka rritje të buxhetit.

Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Fatlum Osmani ua theksoin edhe një herë të pranishmëve se janë të hapur për të pranuar kërkesat e tyre për projekte konkrete, në mënyrë që ato të inkuadrohen në buxhetin e vitit 2022\2023.

Drejtori i urbanizmit, Leutrim Krasniqi u shpjegon të pranishmëve se në kornizën afatmesme buxhetore janë munduar të marrin parasysh të gjitha kërkesat e tyre, por gjithmonë duke u bazuar edhe në mundësinë buxhetore.

Duke u dhënë kështu fjalën të pranishmëve në këtë diskutim publik.

Jusufi, banor i fshatit Dumnicë e epërme – “ne si banorë të një pjese të fshatit Dumnicë e epërme, një mahallë e jonja , kemi nevojë jetike për vazhdimin e një rruge që e lidh rrugën kryesore të fshatit tonë, me mahallën tonë. Rruga që fillon prej xhamisë e lidhet me mahallën tonë, sepse jetën 24 orë ne e kemi të lidhur me rrugën e katunit. Edhe ne jemi dumnicë e epërme. Mundësisht asfaltoni atë pjesë dhe na lidhni me rrugën kryesore të fshatit, sepse edhe fëmijve po i’u vështirësohet rruga për në shkollë gjatë dimrit.

Rexhepi , përfaqësues i fshatit Llaushë – “kërkojmë shtrimin e një pjese të rrugës “Abdyl Dushkolli” e cila e ka bazën komplet por i mungon asfaltimi. Kjo rrugë e lidhë fshatin tonë me fshatin Dobërdol, dhe poashtu po i vështirëson edhe nxënësit, sepse e kalojnë atë rrugë për në shkollë. Dhe stinët e ftohta e sidomos me shi po bëhen shumë problem për të gjithë banorët. Poashtu kërkojmë dhe rregullimin e një kanalizimi, i cili është i gjatë 80 metra, dhe ka shumë problem sepse po kundërmon shumë era, dhe për fund mungon edhe ndriqimi, dhe shtrimi i rrugicave. Por me theks te rregullimi i rrugëve kryesore një herë e pastaj edhe rrugicat nëse ka mundësi.

Drejtori Osmani si përfundim i inkurajon të ftuarit që të bëjnë edhe me shkrim kërkesat e tyre, duke theksuar se me këtë rritje të buxhetit do të merren parasysh kërkesat por gjithmonë duke pasur parasysh se buxheti nuk arrin t’i mbulojë të gjitha atom kërkesa, por që Komuna e Podujevës do të mundohet të mbulojë ato të cilat janë më primare, në të gjitha fushat.

19 gusht, Podujevë



Komuna e Podujevës - Dëgjime Publike për Buxhetin 2022/2023



Festa